

VENDIM
Nr. 135, datë 15.11.2013

**PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE,
SHOQËRISË “ERS - 08 SHPK”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “a” dhe 15 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, pasi shqyrtoi informacionin për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “ERS - 08 sh.p.k.”,

konstatoi se:

Argumentet e shoqërisë janë të drejta dhe, gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1 (germa “a” dhe “d”) të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008 “Për dhënien e licencës shoqërisë “ERS - 08 sh.p.k.” në aktivitetin e “Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik Kavajë”, i ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 28.5.2009 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 63, datë 13.6.2008 “Për dhënien e licencës në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik Kavajë””.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti